



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2395/ 6 prot.

Datë 17 /10/2025

V E N D I M

Nr. 1470/2025

komisioni i prokurimit publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17 /10/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “2 AS INVEST” shpk & “PRATESO” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-54887-07-15-2025, me objekt “Blerje kablllo fuqie dhe aksesore ndihmës”, me fond limit 89,999,882.00 Lekë pa TVSH, (Tetëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH ose e konvertuar në valute; 919.962 (nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSH sipas nivelit të këmbimit zyrtar dt. 15.07.2025 të Bankës së Shqipërisë (1 EUR = 97.83) lek) zhvilluar me datë 18-08-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan.

Ankimues:

BOE “2 AS INVEST” shpk me Nipt M11803504B, me adresë Lagjja 13, ZK 8518, nr. pasurie 58/338+1-43 Durrës dhe & “PRATESO” shpk me Nipt K21707002R” me adresë: ZK 2105 NR.pasurie 1168 /19-ND ,Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan.

Adresa: Rr. "Kadri Abdihoxha", "Lagjja 28
Nentori" Elbasan.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16-07-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-54887-07-15-2025, me objekt “Blerje kablllo fuqie dhe aksesore ndihmës”, me fond limit 89,999,882.00 Lekë pa TVSH, (Tetëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH ose e konvertuar në valute; 919.962 (nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSH sipas nivelit të këmbimit zyrtar dt. 15.07.2025 të Bankës së Shqipërisë (1 EUR = 97.83) lek) zhvilluar me datë 18-08-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan.

II.2 Në datën 26.08.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. BOE“2AS INVEST SHPK & PRATESO”SHPK	83,000,000 lekë Skualifikuar
2. “G. M ENERGY” SHPK	86.776.350 lekë Kualifikuar
3. “BE-IS” SHPK	89.169.120 lekë Kualifikuar

II.4. Në datën 29.08.2025 Autoriteti Kontraktor ka publikuar Njoftim fituesin paraprak e procedurës së prokurimit në sistemin të prokurimeve elektronike (S.P.E.).

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5768, datë 08.09.2025 dhe me nr. 2395/2025 Prot., dhe protokolluar me datë 08.09.2025 e operatorit ekonomik BOE “2AS INVEST SHPK & PRATESO”SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.6 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2395/1 prot., datë 08.09.2025, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga ankimuesi.

II.7 Më datë 12.09.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i sistemit të shpërndarjes sh.a Drejtoria Rajonale Elbasan, nëpërmjet sistemit, ka ardhur shkresa me nr. 4/17 prot., datë 12.09.2025 në lidhje me vlerësimin ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik BOE “2 AS INVEST SHPK & PRATESO” SHPK protokolluar me tonën me nr. 2395/2 datë 15.09.2025, për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton se AK nuk e ka pranuar ankesën e paraqitur.

II.8 Më datë 12.09.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i sistemit të shpërndarjes sh.a Drejtoria Rajonale Elbasan, nëpërmjet shkresës me nr. 4/18, datë 12.09.2025, me objekt “Shkresë përcjellëse”, gjithashtu bashkëlidhur shkresës përcjellëse është dhe vendimi për shqyrtimin ankesës me nr. 4/17prot., datë 12.09.2025 në lidhje me vlerësimin ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik

BOE “2 AS INVEST SHPK & PRATESO” SHPK protokolluar me tonën me nr. 2395/3 datë 15.09.2025, për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton se AK nuk e ka pranuar ankesën e paraqitur.

II.9. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga operatorët e tjerë ekonomik pjesmarrës, si subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “2AS INVEST SHPK & PRATESO” SHPK, mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, me arsyet se:

“1. • Tek sigurimi i ofertes, eshte e palexueshme shuma per te cilen eshte siguruar BOE gjithashtu eshte i palexueshem dhe objekti i prokurimit. Ne formularin e sigurimit te ofertes nuk eshte percaktuar pjesemarrja e secilit anetar te BOE ne kundershtrim me nenin 88/2 i VKM ku thuhet “Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 4 “Specifikimet teknike” “Formulari i sigurimit të ofertës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi Autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë:

Shtojca 4.

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

*** * ***

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

*** * ***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;*
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;*
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.*

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.1.2. Neni 2 “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.*

III.1.6. Në nenin 83, pika 2, 3, 4, 5 dhe 6 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht si më poshtë vijon: 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente. 3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit. 4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit e ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues. 5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni. 6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së 18 kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

.....

III.1.7. Në nenin 30 “Sigurimi i ofertës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 8, thuhet se: “ 8. Në rastin kur, është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe asaj në vend të dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr. Me të njëjtin rregull, mund të kalohet tek ofertat e renditura në vijim në rast se diferenca e ofertës së radhës me ofertën fituese fillestare, të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, të renditur para saj.”.....

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk

përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III 1.9. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE ankimes, me pretendimin ...*Tek sigurimi i ofertes, eshte e palexueshme shuma per te cilen eshte siguruar BOE gjithashtu eshte i palexueshem dhe objekti i prokurimit. Ne formularin e sigurimit te ofertes nuk eshte percaktuar pjesemarrja e secilit anetar te BOE ne kundërshtim me nenin 88/2 i VKM ku thuhet “Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë*), Komisioni vlerëson se pas verifikimit në sistemin elektronik rezulton se operatori ekonomik ka nga ngarkuar dokumentacionin e kërkuar në kriterin e përcaktuar shtojca 4, “Sigurimi ofertës”, konkretisht dokumentacioni:  Sigurimi i ofertes.pdf (201,7 kB), me të dhënat si në vijim: Seria 0015449, data 18.08.2025, NR. REF-54887-07-15-2025, Drejtoria Rajonale OSSH, Elbasan, BOE: M118035046, (2 AS INVEST) & K21707002R (PRATESO), Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, ky sigurim është i vlefshëm për periudhën nga data 18.08.2025 deri 150 ditë,

ka depozituar, pranë Shoqërisë së Sigurimeve ANSIG sh.a. vlerën prej:	(shuma në shifër)	Niveli i Sigurimit (shuma në fjalë)
		SHUMË

Lëshuar nga Kompania e sigurimit ANSIG Insurance Company.

Sa më sipër, në vlerësim të kriterit, si dhe pas verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE, Komisioni gjykon se, BOE ka kryer sigurimin e ofertës, me të dhënat e sipër mendura në paragrafin e parë të pikës III.1.9, dokumentacion i paraqitur sipas shtojcës 4 pjesë e dokumentave standarte të tenderit. Akoma më tej Komisioni thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të gjithë operatorët ekonomikë duhet të jenë në kushte të barabarta si kur përgatisin ofertat e tyre ashtu edhe kur bëhet vlerësimi i tyre. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Komisioni gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomik me dokumentacionin e dorëzuar ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në shtojcën 4 të dokumenteve të tenderit. Gjithashtu në rast se autoriteti kontraktor ka pasur paqartësi lidhur me dokumentacionin e paraqitur “Polica e sigurimit të ofertës” të ankimesit në lidhur me plotësimin e kërkesave të saj, Komisioni i prokurimit nisur nga arsyeja e skualifikimit si dhe nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga BOE ankimes, autoriteti kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural të sqarimeve sipas parashikimeve të pikës 1 nenit 92, ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 të LPP-së, “Shqyrtimi i ofertave” ku sipas këtij të fundit parashikohet se: 1.

Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” Akoma më tej, kuadri ligjor i parashikuar më lart, autoriteti kontraktor kur ka paqartësi për përbumbushjen e kriterëve/dhe ose për mënyrën e plotësimit të tyre ose leximin e tyre sikurse ka cituar në kthimpërgjigje autoriteti kontraktor me shkresën nr. 4 /17 prot., datë 12.09.2025...*sigurimi ofertës nuk është i plotë në përmbajtje sepse nuk ka të lexueshme vlerën për të cilën është siguruar OE dhe objektin e prokurimit për të cilin është lëshuar... KPP vlerëson se AK, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime sipas pikës 1 së parashikuar nga neni 92 i Ligjit për Prokurimin Publik , ku përcaktohet se “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” [...]*”, për gjithë sa arsyetua më sipër Komisioni vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

Për sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “2AS INVEST SHPK & PRATESO” SHPK, mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, me arsyet se:

“1. • Autorizimet e prodhuesit të kompanive “TT kabeli”, “HES Kablo” dhe “MAREL” lëshuar për anëtarin e BOE “2 AS INVEST” janë të paperkthyer në gjuhën shqipe në kundërshtim me pikën 2.3.2/1 të Kriterëve të Vecanta të kualifikimit/Kapaciteti Teknik), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III .2.1 Autoriteti kontraktor në dokumentat standarde të tenderit për procedurën e hapur mallra me objekt: “Blerje kabllorë fuqie dhe aksesori ndihmës”, “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar” , Drejtoria Rajonale e OSSH-SHA, Elbasan, ka parashikuar si në vijim,

NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X

Anglisht X

III.2.2. Në nenin 24 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.20201 “Për përcaktimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde

të tenderit. 2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, të hartuara nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në seksionin përkatës mbi gjuhën në të cilën mund të hartohen ofertat, ka përcaktuar qartësisht, ofertat duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se për sa kohë në pikën 4.7 të seksioni një (1) “Gjuhët në të cilat hartohen ofertat të cilat janë anglisht dhe shqip”, të dokumenteve të tenderit, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë që për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetar, 2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht, si dhe gjithashtu, si dhe gjithashtu llojit të procedurës, pika 1.6 Lloji i procedurës së prokurimit: “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, rezulton se autoriteti kontraktor e ka përcaktuar vetë dhe në formë të qartë, se për procedurat mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht.

III.2.4 Lidhur me arsyen e skualifikimit të ankimuesit për sa i përket pikës 2.3.2/1 të dokumentave standarte të tenderit, me arsyen se: ...Anëtarë “Prateso” shpk, nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi për zërat e preventivit...

III.2.5 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit, në pikën 2.3.1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

2.3.2 Dokumentacioni

**Per mallrat objekt prokurimi - “Blerje kablllo fuqie dhe aksesore ndihmes”
Operatori Ekonomik duhet te paraqese:**

1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim te prodhuesit / distributorit per mallin e kerkuar. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëëbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe.

III.2.6 Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit BOE “Prateso ” SHPK dhe “2 AS Invest ” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Në përmbushje të kriterit më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kanë dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë: Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 17.08.2025, me Nr. Repertori 2415 dhe Nr. Kolaudimi 889, midis operatorit ekonomik “PRATESO” SHPK, dhe operatorit ekonomik “2 AS Invest ” SHPK. Sipas nenit 1, objekti i kësaj kontrate është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me REF: 54887-07-15-2025, organizuar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH. Në nenin 2 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “PRATESO” SHPK do të kontribuojë në masën 54 % në këtë pjesëmarrje, Shoqëria “2AS INVEEST” SHPK do të kontribuojë në masën 46% në këtë pjesëmarrje. Gjithashtu Bashkimi operatorëve në vijim ka përcaktuar se shoqëria “Prateso” shpk *do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes së ndarë ndërmjet palëve bashkpunuese.*
 - Kontratë Bashkëpunimi (Për bashkimin e operatorëve ekonomik), Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 17.08.2025, me Nr. Repertori 2415, si dhe Nr. Kolaudimi 889, midis operatorit ekonomik “PRATESO” SHPK, dhe operatorit ekonomik “2 AS Invest ” SHPK. Sipas nenit 1, objekti i kësaj kontrate është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me REF: 54887-07-15-2025, organizuar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH”, Elbasan ... Gjithashtu në nenin 2 të Kontratës së Bashkpunimit BOE “PRATESO” SHPK & 2 AS Invest” shpk, **ka përcaktuar se Shoqëria “Prateso” shpk do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes së ndarë ndërmjet palëve bashkpunuese.**
 - Authorization letter, date: 08.08.2025, Object: “Blerje kablllo fuqie dhe aksesore ndihmes” ,Contracting Authority: Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan, Reference number: REF-54887-07-15-2025. Është HES HACILAR ELEKTRIK SANYI VE TICARET A.Ş. hereby authorize, "2AS INVEST" (Dures, Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Nr.Pasurie 58/338+1-43, kati tete), Albania to submit a bid the purpose of which is to provide the MË poëer cables, manufactured by us, and to subsequently negotiate and sign the Contract.
 - **Manufacture’s Authorization, date July 28th, 2025, To: "2AS INVEST" shpk, ID No: M11803504B,ËHERAS MAREL D.o.o ëho are established and reputable manufacturers of accessories for loë and medium voltage distribution netëorks in their factory in Veliko Golovode bb, 37000 Krusevac, Republic of Serbia, do hereby authorize, "2AS INVEST"Dures,Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Nr.Pasurie 58/338+1-43, kati tete, To participate, submitting and negotiating, directly to the interested party or via third parties entering the bidding process for object tender “Blerje kablllo fuqie dhe aksesore ndihmes” of contracting authority Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan ëth REF-54887-07-15-2025.**
- Autorizim Distributori, datë 08.08.2025, Per: Pjesemarrje ne Tender, Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan, Objekti: “Blerje kablllo fuqie dhe aksesore ndihmes,Ref. Tender: REF-54887-07-15-2025, **Santi & Partners shpk**, ne cilesine e “Distributor Zyrtar“ per fabriken Italiane “Elcon Megarad“ spa, që është prodhues i stabilizuar dhe i mirënjohur i

Terminaleve te tensionit të ulët (TU) dhe të mesëm (TM), për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, etj, që ndodhet në Via Nazionale, 110 - 83030 Arcella (AV) - Italy, me anë të këtij dokumenti: *autorizojme paraprakisht "2AS INVEST" sh.p.k. me nipt M11803504B te prezantoje oferte dhe me tej te drejtoje negociata e te nenshkruaje kontrate bashkepunimi me palen tuaj per tenderimin me objekt "Blerje kablllo fuqie dhe aksesore ndihmes" dhe REF54887-07-15-2025.*

- Manufacture's Authorization, date 06.08.2025, To: "2AS INVEST" shpk, Ëhereas TT Cables Bih Bosnia Hercegovina ëho established and reputable manufactures of specialized in the producion and distribution of electrical cables having factories at TT Kabeli dooel Negotino -North Medonia, do hereby authorize the bidder 2 AS Invest vat M11803504B, Durrës LaGJJA 13, Represent TT Kabeli DOOEL Negotino -North Macedonia , in calls for offer in Albanian market , submiting a bit and negotiating , directly to the interested party or via third parties entering the bidding process of object ëith REF 54887-07-15-2025 ëith authority contractor Drejtoria Rajonale E OSSH.

III.2.7. Në nenin 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar parashikohet se: *"Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efëçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.8. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.9. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në*

procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të

kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.10. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

III.2.11. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën 15 përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.2.12. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e

tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e 16 përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.13. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.2.14. Komisioni konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me arsyen e skualifikimit të BOE “Prateso” shpk “2 As Invest” SHPK se: “....operatori ekonomik *anëtari “Prateso” shpk, nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi për zërat e preventivit...*nga verifikimi i dokumentave të tenderit si dhe dokumentave të ngarkuara në SPE nga BOE ekonomik ankimes Komisioni konstaton, se BOE ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e listuar në pikën III.2.6 të këtij vendimi. Referuar arsyes së skualifikimit Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2.,pika 1, të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ka përcaktuar se: “ *Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim te prodhuesit / distributorit per mallin e kerkuar. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe.* Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e

ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret BOE “Prateso” shpk “2 As Invest” SHPK dhe ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.2.6 të këtij vendimi. Referuar kontratës së bashkëpunimit e lidhur më datë 17.08.2025, me Nr. Repertori 2415, si dhe Nr. Kolaudimi 889, midis operatorit ekonomik “PRATESO” SHPK, dhe operatorit ekonomik “2 AS Invest ” SHPK, në nenin 2 përcaktohet se: “Shoqëria “PRATESO” SHPK, *do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes se ndare ndermjet paleve bashkpunuesese*, si dhe gjithashtu ka të përcaktuar në mënyr specifike kontributin e secilit anëtar të bashkimit të perkohshem ku shoqëria “Prateso shpk ka 54/% dhe shoqëria “2 As Invest” shpk ka 46 %. Rezulton se operatori ekonomik “PRATESO ” SHPK ka marrë përsipër të kryejë 54 % të shërbimeve. Ndërkohë në nenin 2 paragrafi fundit të kontratës së bashkëpunimit përcaktohet se: “Shoqëria “Prateso” SHPK, *do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes se ndare ndermjet paleve bashkpunuesese*”. Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “PRATESO ” SHPK, ka marrë përsipër të kryejë 54 % e cila është *mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes se ndare ndermjet paleve bashkpunuesese*. Akoma më tej BOE në kontratën e bashkëpunimit kanë përcaktuara se, *me prokure te posacme do te autorizohet shoqëria 2s Invest shpk per perfaqsimin e ketij bashkimi shoqërish per dorezimin e ofertes per te aplikuar konkurruar online ne faqen zyrtare te APP per te nenshkruar cdo dokument te nevojshem apo kontrata te ndryshme ne emer te bashkimit te operatoreve per realizimin e dokumentacionit lidhur me kapacitet ligjore financiare teknike që disponojme per te nenshkruar kontraten me autoritetin kontraktor dhe pe rre ndjekur te gjitha procedurat ne zbatim te kontrates deri ne perfundimin e plote te saj nëse rezultojnë fitues per perfaqsimin e saj ne te gjitha ralionet me punedhenesin dhe cdo plae tjetër që lidhet me ekzekutimin e kesaj kontrate ne rast te shpalljes fitues*. Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të VKM ku parashikohet se: “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh, dhe në kushtet kur operator i e tjetër ka dorëzuar Autorizimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.3.2 pika 1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit përmbushet nga i gjithë bashkimi. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik dhe dokumenteve të tenderit, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të bëjë verifikimet dhe monitorimet përkatëse, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të ankimuesit “BOE “2 AS INVEST” shpk & “PRATESO” shpk”, me arsye se :

“1. “Marreveshja e bashkepunimit nuk percakton se cilet elemente merr persiper te realizoje secili prej anetareve te bashkimit ne kundershtrim me piken 1 Kriteret e Pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit dhe me nenin 81/1 te VKM Nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*

III.3.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kanë dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

III.3.3 . Në përmbushje të kriterit më sipër, Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kanë dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë: Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 17.08.2025, me Nr. Repertori 2415 dhe Nr. Kolaudimi 889, midis operatorit ekonomik “PRATESO” SHPK, dhe operatorit ekonomik “2 AS Invest ” SHPK. Sipas nenit 1, objekti i kësaj kontrate është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me REF: 54887-07-15-2025, organizuar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH. Në nenin 2 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “PRATESO” SHPK do të kontribuojë në masën 54 % në këtë pjesëmarrje, Shoqëria “2AS INVEEST” SHPK do të kontribuojë në masën 46% në këtë pjesëmarrje. Gjithashtu Bashkimi operatorëve në vijim ka paërcaktuar se shoqëria “Prateso” shpk do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes së ndarë ndërmjet palëve bashkpunuese.

III.3.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe*

jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikon se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.6. Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të të VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, 50 punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.*

III.3.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Komisioni konstaton se oferta me numër: OFFER-6019/18082025, datë 18.08.2025 është aplikuar dhe dorëzuar në këtë sistem për këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, oferta si bashkim operatorësh ekonomikë “PRATESO ” SHPK & “2 AS ” SHPK, vërtetuar kjo jo vetëm nga verifikimi i formularit të ofertës por edhe shtojcës 9 formulari përmbledhës i vetëdeklarimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorit ekonomikë “PRATESO ” SHPK & “2 AS ” SHPK, Komisioni konstaton se është dorëzuar edhe dokumentit Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 17.08.2025, me Nr. Repertori 2415 dhe Nr. Kolaudimi 889, midis operatorit ekonomik “PRATESO” SHPK, dhe operatorit ekonomik “2 AS Invest ” SHPK, sipas parashikimeve të nenit 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 2 dhe 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për më tepër, Komisioni konstaton se në dokumentacionin e ofertës është dorëzuar nga ana e ofertuesit “PRATESO ” SHPK dhe “2 AS INVEST ” SHPK Shtojca 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku në Seksionin A “Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik” secili nga anëtarët e bashkimit ka deklaruar së ka ofertuar si bashkim operatorësh ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik referuar legjislacionit në fushën e prokurimit publik vëren se, ligji 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon se grupe të operatorëve ekonomikë, në një procedurë prokurimi dorëzojnë oferta si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore të paraqitjes së ofertave, përse kohë nuk është parashikuar një formë e tillë në DST për bashkimin e operatorëve ekonomikë në kuptim të parashikimeve të nenit 14 pika 2 të lex specialis . Gjithashtu në nenin 88, të VKM-së anëtarët e BOE përcaktojnë në marrëveshjen e tyre përgjegjësitë dhe detyrat që do të kryejnë secili në këtë bashkim. Në rastin

konkret operatorët ekonomikë në këtë BOE marrin përsipër në përputhje me kapacitetet e tyre, elementë të caktuar të kontratës me qëllimin final të realizimit të saj me sukses. Referuar dokumentacionit të tenderit, shtojcave përkatëse, vërehet se AK ka parashikuar shtojcat 1/1, Formularin e Ofertës dhe shtojcën 3, Lista e çmimeve, si formate për t'u paraqitur si nga operatorët ekonomike të cilët ofertojnë të vetëm në këtë procedurë prokurimi **ashtu edhe nga BOE, pra pa specifikuar një formë të veçantë të paraqitjes së ofertës me të cilën ofertojnë subjektet si pjesëmarrës në procedurën e prokurimit**. Ankimuesi BOE “PRATESO ” SHPK dhe “2 AS INVEST ” SHPK, në përmbushje të shtojcës 1/1 dhe 3 ka paraqitur ofertën ekonomike bashkëlidhur së cilës ka listuar zërat e kërkuar me vlerat përkatëse. Me të drejtë ankimuesi ngre pretendimet e tij dhe i argumenton me sqarime se BOE nëpërmjet Kontratës së Bashkëpunimit (Për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë) midis palëve në këtë BOE ka përcaktuar qartë ndarjen proporcionale të dy shoqërive në këtë kontratë, rolet, të drejtat dhe detyrat, përgjegjësitë e secilit operator ekonomik në këtë bashkim të përkohshëm, të cilët marrin përsipër të realizojë detyrat sipas ndarjeve që ata kanë përcaktuar në mënyrë të qartë, me qëllim realizimin e kontratës në kohë dhe me cilësinë e kërkuar në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se oferta ekonomike e paraqitur nga ankimuesi është e rregullt dhe në përputhje me formatet dhe përmbajtjen e kërkuar në DST të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që: Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementet që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit”. Në përmbushje të saj, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar në SPE Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 17.08.2025, me Nr. Rep 2415 dhe Nr. Kol 889 midis Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Prateso ” SHPK & “2 AS Invest ” SHPK. Sipas nenit 2, objekti i kësaj kontrate është bashkimi i përkohshëm të shoqërive për të marrë pjesë konformë procedurave përkatëse në procedurën e prokurimit, “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-54887-07-15-2025, me objekt “Blerje kablllo fuqie dhe aksesore ndihmës”, me fond limit 89,999,882.00 Lekë pa TVSH, (Tetëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH ose e konvertuar në valute; 919.962 (nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSH sipas nivelit të këmbimit zyrtar dt. 15.07.2025 të Bankës së Shqipërisë (1 EUR = 97.83) lek) zhvilluar me datë 18-08-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan. Në nenin 2 të kësaj kontrate pjesëmarrja janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “PRATESO” SHPK do të kontribuojë në total në masën 54 % në këtë pjesëmarrje, dhe Shoqëria “2 AS Invest ” SHPK do të kontribuojë në total në masën 46 % në këtë pjesëmarrje, **si edhe është përcaktuar që shoqëria “Prateso” shpk do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes së ndarë ndërmjet palëve bashkëpunuese**. Shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë pjesëmarrje do të kontribuojnë edhe me kapacitetin teknik, financiar të cilat do të vendosen në dispozicion për të përmbushur plotësisht objektin e kontratës. Bazuar në këtë kontratë lidhur mes palëve 54 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “2 AS Invest ” SHPK ndërsa 46 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “2 AS Invest ” SHPK. Referuar kontratës së bashkëpunimit konkretisht nenit 2 të saj si dhe arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, rezulton se nuk

qëndron, pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar një kontratë bashkëpunimi ku ka evidentuar, palët edhe kontributet e tyre të shprehura jo vetëm në përqindje, ashtu siç është kërkuar dhe në dokumentet e tenderit ku duhet përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes në bashkim por në nenin 1 dhe 2 të saj janë përcaktuar edhe elementët që do të marrë përsipër dhe do të realizojë secila palë në bashkëpunim ku në nenin 1 citohet :

Me prokurë te posaçme do te autorizohet Shoqëria "2AS INVEST" SHPK për përfaqësimin e këtij bashkimi shoqërisht, për dorëzimin e ofertës, për te aplikuar/konkuruar online ne faqen zyrtare te APP, për te nënshkruar cdo dokument te nevojshëm apo kontrata te ndryshme ne emer te bashkimit te operatoreve per realizimin e dokumentacionit te kërkuar ne fazën e konkurrimit ne APP, për te përdorur dokumentacionin lidhur me kapacitetet ligjore, financiare, teknike qe disponojmë, për te nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktor dhe për te ndjekur te gjitha procedurat ne zbatim te kontratës deri ne përfundimin e plote te saj nëse rezultojme fitues, për përfaqësimin e saj ne te gjitha relacionet me punëdhënësin dhe cdo pale tjetër qe lidhet me ekzekutimin e kësaj kontrate ne rast te shpalljes fitues.

Te dyja shoqëritë ne këtë kontrate bashkëpunimi do te jene bashkërisht dhe secila përgjegjëse për përmbushjen e kontratës ne përputhje me te gjitha termat e saj, sipas ndarjes se me poshtme:

NENI 2

PJESËMARRJA NE BASHKIMIN E PËRKOHSHËM

Ne mënyre me specifike kontributi i secilit anëtarë te bashkimit te përkohshëm ne përmbushjen e kriterëve te veçanta te kualifikimit dhe ne realizimin e kontratës me pas, nëse shpallet fitues do te jete si me poshtë:

- Shoqëria "PRATESO" SHPK 54%,
- Shoqëria "2AS INVEST" SHPK 46%

Shoqëritë e lartpërmendura do te vene ne dispozicion te objektit te mësipërm, gjithë kapitalin e tyre financiar, intelektual, makineritë dhe personelin teknik qe disponojnë. Ato do te ofrojnë te gjitha mjetet e tyre logjistike, kapacitetet financiare, stafin inxhiniero-teknik dhe eksperiencën e tyre si grup i vetëm.

Shoqëria "Prateso" sh.p.k, do te jete mbështetës ne kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes se ndare ndermjet paleve bashkepunuëse.

KPP vë re se në asnjë rresht të dokumenteve të tenderit apo kriter për kualifikim, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kontrata e bashkëpunimit midis palëve të ketë të evidentuar përveç përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementet që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit edhe vlerën e shërbimit. Në kuptim të sa më sipër, në marrëveshjen e bashkëpunimit të ngarkuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes janë përcaktuar qartë përqindja pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit, si edhe elementët konkretë që do të kryejë secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në marrëveshjen e bashkëpunimit, ashtu siç edhe përcaktohet në legjislacionin në fuqi, përcaktohen të gjitha të dhënat sic janë përqindja e bashkëpunimit si edhe zërat/elementët konkretë që do të marrë përsipër për të kryer secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me dokumentat e tenderit dhe nenin 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori

ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “PRATESO ” SHPK & “2 AS Invest ” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimesit për kundërshtimin e skualifikimit të tij, për kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon pikës; 2.3.2/5, *kerkesat per kualifikim te parashikuara ne pikat ne pikat 2.3.2/5, te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim/Kapaciteti Teknik, nuk plotesohen nga anetari i BOE , “PRATESO” shpk per arsye se;*

Ne vetedeklarimet e paraqitura nga anetari i BOE, “2 AS INVEST” per permbushjen e ketyre kater kerkesave per kualifikim, kjo shoqeri thekson se i ben keto deklarata dhe ne emer te anetarit te BOE , “PRATESO” sh.p.k. duke marre persiper ne kete menyre qe te plotesoje kerkesat per kualifikim per anetarin tjeter te BOE...

III.4.1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën 8, te DST 2.3.2 pika 5; të dokumentave standarte të tenderit:

2.3.2 Dokumentacioni

***Për mallrat objekt prokurimi - “Blerje kablo fuqie dhe aksesore ndihmës”
Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:***

5.Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklarone se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve, ose furnizuesit/ve, eshte sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara.

III.4.2 Në përmbushje të kriterit 2.3.2, pika 5 të DST, BOE “Prateso ” SHPK & “2 AS Invest ” shpk dhe ndër të tjera ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

Në përmbushje të kërkesave për kualifikim të kërkuara konkretisht në pikën 2,3.2/ 5; pjesë e dokumentave standart të tenderit Bashkimi operatorëve ka ngarkuar nën sistemin elektronik dokumentat si në vijim me të dhëna :

-“Vetedeklarim Date 18/08/2025 BOE 2AS INVEST me nipt M11803504B dhe PRATESO me nipt K21707002R deklarone se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesve, ELCON Megarad, HES Kablo, Marel dhe TT Kablo eshte sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara. Duke qene se oferta do te paraqitet nga subjekti lider ne BOE 2AS INVEST SHPK me nipt M11803504B kjo deklarate do te firmoset dhe vulozet nga Administratori I kompanise 2AS INVEST.”.

- ISO 9001: 2015 2AS INVEST Sh.p.k Sistemi i menaxhimit të cilësisë

- ISO 9001: 2015 Prateso sh.p.k Sistemi i menaxhimit të cilësisë

- Kontratë për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë, datë 17.08.2025 lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë “Prateso” SHPK, dhe “2 AS Invest ” SHPK ku në pikën 2. Pjesëmarrja e anëtarëve për arritjen e objektit të kësaj kontrate do të jetë si vijon: poshtë: 1. Shoqëria “Prateso” shpk 54 % të pjesëmarrjes, shoqëria “ 2 AS Invest” shpk 46 % të pjesëmarrjes si dhe në vijim përcaktohet se: shoqëritë e lartë përmendura do të vendosen në dispozicion të objektit të mesipërm gjithë kapitalin e tyre financiar, intelektual, makineritë dhe personelin teknik që disponojnë, ato do të ofrojnë të gjitha mjete e tyre logjistike, kapacitet financiar , stafin inxhiniero- teknik dhe eksperiencën e tyre si grup i vetëm. Shoqëria Prateso shpk do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipa përqindjes së ndarë ndërmjet palëve bashkpunuese teknike “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike do të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, apo fokusit kryesor të secilit anëtar, të përcaktuara në akt marrëveshje.

III.4.3. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të 14 përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të

kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.4.4. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën 15 përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.4.5. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkojë, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto

korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rëndësi me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

III.4.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për

përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me arsyen e skualifikimit të BOE “Prateso ” shpk “2AS Invest” SHPK se: “....operatori ekonomik “Prateso” shpk nuk ploteson kërkesen e percaktuar ne 2.3.2 pika 5, nga verifikimi i dokumentave të tenderit si dhe dokumentave të ngarkuara në SPE nga BOE ankimues Komisioni konstaton, se BOE ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e listuar në pikën **III.4.2 të këtij vendimi**. Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret BOE ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.4.2 të këtij vendimi. Referuar kontratës së bashkëpunimit për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik datë, datë 17.08.2025 lidhur ndërmjet operatorëve ekonomik “Prateso” SHPK, dhe “2 AS Invest ” SHPK, në nenin 2 përcaktohet në mënyrë specifike kontributin e secilit anëtar të bashkimit të perkohshëm ku shoqëria “Prateso shpk ka 54/% dhe shoqëria “2 As Invest” shpk ka 46 %. Rezulton se operatori ekonomik “PRATESO ” SHPK ka marrë përsipër të kryejë 54 % të shërbimeve. Ndërkohë ne nenin 2 paragrafi fundit të kontratës së bashkëpunimit përcaktohet se: “Shoqëria “Prateso” SHPK, *do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes së ndare ndërmjet paleve bashkpunuesesë*”. Akoma më tej BOE në kontratën e bashkëpunimit kanë të përcaktuara se, *me prokurë të posacme do të autorizohet shoqëria 2s Invest shpk për perfaqsimin e këtij bashkimi shoqërisht për dorezimin e ofertes për të aplikuar konkurrues online në faqen zyrtare të APP për të nënshkruar çdo dokument të nevojshëm apo kontratë të ndryshme në emër të bashkimit të operatorëve për realizimin e dokumentacionit lidhur me kapacitet ligjorë financiare teknike që disponojmë për të nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktor dhe për të ndjekur të gjitha procedurat në zbatim të kontratës deri në përfundimin e plotë të saj nëse rezultojnë fitues për perfaqsimin e saj në të gjitha racionet me punedhenesin dhe çdo palë tjetër që lidhet me ekzekutimin e kësaj kontrate në rast të shpalljes fitues*. Përveçse rezulton se BOE ka ngarkuar në sistemin elektronik vetdeklarimin në funksionin të përmbushjes së kriterit 2.3.2 pika 5 nga verifikimi rezulton se ka ngarkuar në sistem dhe ISO 2009:2015 Prateso shpk si dhe ISO 2009:2015 për “2A INVEST” shpk, për sistemin e menaxhimit të cilësisë. Në kontratën e bashkëpunimit në nenin 2 ka të përcaktuar në mënyrë specifike kontributin e secilit anëtar të bashkimit të perkohshëm ku shoqëria “Prateso shpk ka 54/% dhe shoqëria “2 As Invest” shpk ka 46 %. Rezulton se operatori ekonomik “PRATESO ” SHPK ka marrë përsipër të kryejë 54 % të shërbimeve. Ndërkohë ne nenin 2 paragrafi fundit të kontratës së bashkëpunimit përcaktohet se: “Shoqëria “Prateso” SHPK, *do të jetë mbështetëse në kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas përqindjes së ndare ndërmjet paleve bashkpunuesesë*”. Akoma më tej BOE në kontratën e bashkëpunimit kanë të përcaktuara se, *me prokurë të posacme do të autorizohet shoqëria 2s Invest shpk për perfaqsimin e këtij bashkimi shoqërisht për dorezimin e ofertes për të aplikuar konkurrues online në faqen zyrtare të APP për të nënshkruar çdo dokument të nevojshëm apo kontratë të ndryshme në emër të bashkimit të operatorëve për realizimin e dokumentacionit lidhur me kapacitet ligjorë financiare teknike që disponojmë për të nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktor dhe për të ndjekur të gjitha procedurat në zbatim të kontratës deri në përfundimin e plotë të saj nëse*

rezultojnë fitues për përfaqsimin e saj në të gjitha ralionet me punedhënesin dhe çdo plaç tjetër që lidhet me ekzekutimin e kësaj kontrate në rast të shpalljes fituese”. Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPPsë, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “Prateso” SHPK ka marrë përsipër të kryejë vetëm 54% të shërbimeve. Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të VKM ku parashikohet se: “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh, dhe në kushtet kur është ngarkuar Vetdeklarimi i datës 18.08.2025 sipërmendur në pikën III.4.2 si dhe gjithashtu në funksion të përmbushjes të këtij kriteri janë ngarkuar edhe Certifikatat ISO-t 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë, kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.3.2, pika 5 të kriteve të veçanta të kualifikimit përmbushet nga i gjithë bashkimi operatorëve ekonomik. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik dhe dokumenteve të tenderit, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të bëjë verifikimet dhe monitorimet përkatëse, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit operatorëve ekonomik qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e ankimesit për kundërshtimin e kualifikimit të tij, për kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon pikës; **2.3.2/6; kërkesat për kualifikim të parashikuara në pikën, 2.3.2/ 6, të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim/Kapaciteti Teknik, nuk plotësohen nga anetari i BOE, “PRATESO” shpk për arsye se; Ne vetedeklarimet e paraqitura nga anetari i BOE, “2 AS INVEST” për përmbushjen e ketyre kërkesave për kualifikim, kjo shoqëri thekson se i ben keto deklarata dhe ne emer te anetarit te BOE, “PRATESO” sh.p.k. duke marre persiper ne kete menyre qe te plotesoje kërkesat për kualifikim për anetarin tjetër të BOE...**

III.5.1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën 8, të DST pika 2.3.2/ 6, të dokumentave standarte të tenderit:

2.3.2.Dokumentacioni

***Për mallrat objekt prokurimi - “Blerje kablllo fuqie dhe aksesorë ndihmës”
Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:***

1. Pika 2.3.6 të Kapacitetit Teknik

ISHTE:

“ Operatori ekonomik duhet te paraqese certificate akreditimi ISO 17025 te laboratorit te prodhuesit (ose distributorit i autorizuar) per testimin e kablllove me izolacion XLPE ose ekuivalenten e saj sipas Drejtorise se Pergjithshme te Standartizimit Shqiptar”.

BEHET:

“ Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklarone se laboratorit i prodhuesit (ose distributorit te autorizuar) per testimin e kablllove me izolacion XLPE, disponon certificate akreditimi ISO 17025

III .5.2. Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar ne sistemin elektronik dokumentacionin si në vijim:

Date 18/08/2025

VETEDEKLARIM

BOE 2AS INVEST me nipt M11803504B dhe PRATESO me nipt K21707002R deklarone se laboratorit i prodhuesit HES Kablo dhe TT kablo per testimin e kablllove me izolacion XLPE, disponon certificate akreditimi ISO 17025. Duke qene se oferta do te paraqitet nga subjekti lider ne BOE 2AS INVEST SHPK me nipt M11803504B kjo deklarate do te firmoset dhe vuloset nga Administratori i kompanise 2AS INVEST.

III.5.3 Lidhur me përmbushjen e kriterit, pika 2.3.2 pika 6, Komisioni, pas verifikimeve të dokumentacionit në sistemin elektronik SPE rezulton se, BOE ankimues ka ngarkuar në sistemin elektronik dokumentacionin “Vetëdeklarim”, data 18.08.2025 lidhur me disponimin e certifikatës ISO 17025. Për sa më sipër Komisioni vlerëson se referuar kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor pika 2.3.2, pika 6 ku përcaktohet ...**bëhet:** “ operatori ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklarone se laboratorit i prodhuesit (ose distributorit te autorizuar) per testimin e kablllove me izolacion xlpe, disponon certificate akreditimi ISO 17025”, BOE ankimues për sa kohë ka ngarkuar ne SPE dokumentacionin në përmbushje të kriterit 2.3.2 pika 6 të kërkuar në DST , është në kushtet e përmbushjes së kriterit ashtu sikurse është kërkuar në dokumentat standarte të tenderit nga vet autoriteti kontraktor, ndaj Komisioni në vlerësim të fakteve gjykon se BOE ankimues, ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2, pika 6 e dokumentave standarte të tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.5.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për kundërshtimin e skualifikimit të tij, për kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon pikës; **2.3.2/7 të DST-së... kërkesat per kualifikim te parashikuara ne pikat ne pikat, 2.3.2/7, te Kërkesave te Vecanta per Kualifikim/Kapaciteti Teknik, nuk plotesohen nga anetari i BOE , “PRATESO” shpk per arsye se; Ne vetedeklarimet e paraqitura nga anetari i BOE, “2 AS INVEST” per permbushjen e ketyre kater kërkesave per kualifikim, kjo shoqeri thekson se i ben**

keto deklarata dhe ne emer te anetarit te BOE , “PRATESO” sh.p.k. duke marre persiper ne kete menyre qe te plotesoje kerkesat per kualifikim per anetarin tjeter te BOE...

III.5.5 Autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën 8, te DST pika 7, të dokumentave standarte të tenderit se :

2.3.2 Dokumentacioni

***Për mallrat objekt prokurimi - “Blerje kablo fuqie dhe aksesore ndihmës”
Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:***

Operatori Ekonomik duhet te paraqese deklarate konformiteti ku te shprehet qe materialet të kenë markim CE.

III.5.6 Në përmbushje të kriterit të sa më sipër, operatori BOE ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë::

- *Declaration of Conformity, No: 13/009, Name manufacturer: “Marel d. o. o.” CE. Date 18.12.2023.*
- *Declaration of Conformity, No: 13/011, Name manufacturer: “Marel d. o. o.” CE. Date 18.12.2023.*

III.5.7. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.8. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.9. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë

bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të lotëve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. 19 Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.” Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.10. Në pikën 6 të nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, 7 mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.5.11. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit “2.3.3 pika 7 “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2.3.2 pika 7 . Nisur nga arsyeja e skualifikimit si dhe gjithashtu referuar kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 pika 7 pjesë e dokumentave standarte , lidhur me përmbushjen nga ana e tij të kriterit më sipërm, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, BOE ankimues e ka përmbushur kriterin e sipërcituar. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik për

përmbushjen e kriterit më sipërm, ankimuesi ka ngarkuar dokumentacionin -“ *Declaration of Conformity, No: 13/009, Name manufacturer: “Marel d. o. o.” CE. Date 18.12.202*”.- *Declaration of Conformity, No: 13/011, Name manufacturer: “Marel d. o. o.” CE. Date 18.12.2023.*”, nga ku rezulton se në përmbushje të kriterit ku “*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE*”, ankimuesi i ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2/ 7 në përmbushjen të kriterit të sipërcituar. Referuar sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se BOE ankimues e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentet e tenderit konkretisht në pikën 2.3.2 pika 7, të kapacitetit teknik, në kriteret e veçanta të kualifikimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i pa vlefshëm, e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e e ankimuesit për kundërshtimin e skualifikimit të tij, për kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, *...kerkesat për kualifikim të parashikuara në pikat në piken, 2.3.2/8, të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim/Kapaciteti Teknik, nuk plotësohen nga anetari i BOE, “PRATESO” shpk për arsye se; Ne vetedeklarimet e paraqitura nga anetari i BOE, “2 AS INVEST” për përmbushjen e ketyre kater kërkesave për kualifikim, kjo shoqëri thekson se i bën keto deklaratë dhe në emër të anetarit të BOE, “PRATESO” sh.p.k. duke marrë persiper në këtë mënyrë që të plotësojë kërkesat për kualifikim për anetarin tjetër të BOE...*

III.6.1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën 8, të DST 2.3.2, pika 8, të dokumentave standarte të tenderit:

1. Pika 2.3.8 të Kapacitetit Teknik

ISHTE:

“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatë leshuar nga prodhuesi (ose distributori i autorizuar) që kabllo të ofruara janë në përputhje me standardin e harmonizuar European HD 603, ose ekuivalentin e saj sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit Shqiptar”

BEHET:

“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetedeklarim që kabllo të ofruara janë në përputhje me standardin e harmonizuar European HD 603”.

III.6.2 Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar në sistemin elektronik dokumentacionin si në vijim:

VETEDEKLARIM

BOE 2AS INVEST me nipt M11803504B dhe PRATESO me nipt K21707002R deklarojnë se kabllo e ofruara janë në përputhje me standartin e harmonizuar European HD 603. Duke qene se oferta do të paraqitet nga subjekti lider në BOE 2AS INVEST SHPK me nipt M11803504B kjo deklarate do të firmoset dhe vuloset nga Administratori i kompanisë 2AS INVEST.

Lidhur me përmbushjen e kriterit, pika 2.3.2 pika 8, Komisioni, pas verifikimeve të dokumentacionit në sistemin elektronik SPE rezulton se, BOE ankimues ka ngarkuar në sistemin elektronik dokumentacionin “Vetëdeklarim”, data 18.08.2025 lidhur me me standartin e harmonizuar E uropian HD 603. Për sa më sipër Komisioni vlerëson se referuar kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor pika 2.3.2, pika 6 ku përcaktohet ... **Bëhet:**

“Operatori Ekonomik duhet të paraqese vetedeklarim qe kabllo e ofruara janë në përputhje me standartin e harmonizuar European HD 603”, BOE ankimues për sa kohë ka ngarkuar në SPE dokumentacionin vetëdeklarim ... se kabllo e ofruara janë në përputhje me standartin e harmonizuar European HD 603, BOE “Prateso shpk & 2AS Invest” shpk është në kushtet e përmbushjes të kriterit 2.3.2, pika 8 , sikurse është kërkuar në dokumentat standarte të tenderit nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i BOE ankimues, qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1.Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Prateso” sh.p.k & “2AS Invest” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-54887-07-15-2025, me objekt “Blerje kabllo fuqie dhe aksesore ndihmës”, me fond limit 89,999,882.00 Lekë pa TVSH, (Tetëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH ose e konvertuar në valute; 919.962 (nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSH sipas nivelit të këmbimit zyrtar dt. 15.07.2025 të Bankës së Shqipërisë (1 EUR = 97.83) lek) zhvilluar me datë 18-08-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Elbasan.

2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik sipas konstatimeve të mësipërme të vendimit të Komisionit të prokurimit publik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Prateso” sh.p.k & “2AS Invest” shpk.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Florent Zguro

